

Nr. 2504/031 K (e-k) Prot.
Tiranë, më datë 29/04/2025

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Z. Ilirjan CELIBASHI

Lënda: **DENONCIM Nr. 18** – Lidhur me organizimin e koncerteve/shfaqjeve kulturore argëtuese përgjatë ose në lidhje me tubimet elektorale nga Subjekti Zgjedhor “Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Shqipërinë Madhështore”.

I Nderuar Z. Komisioner!

Të nderuar Kolegë të Administratës së KQZ-së!

Neni 78 i Kodit Zgjedhor “Të drejtat dhe detyrimet e subjekteve zgjedhore gjatë fushatës”, në pikën 9 të tij përcakton se “*Subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve u ndalohet të organizojnë, kryejnë apo mbulojnë shpenzimet vetë ose nëpërmjet të tretëve për koncerte, shfaqje kulturore argëtuese apo veprimtari bamirësie, pavarësisht nëse ato mbahen përgjatë ose në lidhje me tubimet elektorale, apo zhvillohen si veprimtari fushate ose jashtë saj.*”

Në datën 11 prill 2025 në Tiranë, Subjekti Zgjedhor “Partia Demokratike - Koalicioni Aleanca për Shqipërinë Madhështore” zhvilloi një tubim elektorale për hapjen e fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Parlamentare të datës 11 maj 2025. Në këtë takim elektorale **kanë marrë pjesë edhe këngëtarë të cilët kanë kënduar këngë përgjatë eventit (videon e gjeni të publikuar [në këtë lidhje](#)).**

Aktiviteti elektorale është transmetuar Live në disa media si: [Top-Channel](#), [News24](#), [Vizion Plus](#), [Report TV](#), etj., në faqet zyrtare në rrjetet sociale, si dhe në edicionet informative të lajmeve të transmetuara prej këtyre mediave.

Në pamjet foto dhe video ([link](#)) të postimeve të paraqitura në vijim të këtij denoncimi (*Lidhja nr. 1*) evidentohet qartë thirrja, organizimi i veprimtarisë si dhe prezenca e materialeve propagandistike të fushatës elektorale të Subjektit Zgjedhor “Partia Demokratike - Koalicioni Aleanca për Shqipërinë Madhështore” për Zgjedhjet e 11 majit 2025.

Konkludohet se **kemi të bëjmë me një tubim elektorale**, i cili i ka të gjitha elementët përbërës të tij si fjalime, thirrje, pankarta, slogane, logo, si dhe **me zhvillimin në të njëjtën kohë përgjatë tij të një koncerti/shfaqjeje kulturore argëtuese me këngëtar të ftuar**, i cili performon, këndon dhe shfaqet në mbështetje të këtij subjekti zgjedhor. (shih minutat 31:12 – 33:26; 1:02:18 – 1:06:06 dhe 1:17:34 – 1:22:30 [në video](#) ku shfaqet dhe këndon këngëtari Renis Gjoka dhe grupi i tij Band).

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Madje, ndër të tjera prezantuesja në paraqitjen e këngëtarit shprehet se: “Para momentit final të hapjes, një intermexo muzikore, **pak rrok në skenë** për tu bërë gati për rokstarin e rezistencës opozitare, ftoj përsëri në skenë Renis Gjoka dhe Band me “Një hap përpara””. (Minuta 1:17:34 – 1:22:30 e videos)

Rezulton se **Subjekti Zgjedhor “Partia Demokratike - Koalicioni Aleanca për Shqipërinë Madhështore (PD – ASHM)”** ka organizuar veprimtari që hyn në sferën e ndalimeve të parashikuar në nenin 78 pika 9 të Kodit Zgjedhor, duke qenë ndërkohë edhe përfituesja e vetme dhe e drejtëpërdrejtë prej saj.

Referuar sa më sipër, ju përcjellim këtë **Denoncim për t’u marrë në shqyrtim prej KQZ-së** e kryer hapat e parashikuar procedurale lidhur me këtë shkelje të Kodit Zgjedhor, për të cilën **nevojitet të sanksionohet subjekti zgjedhor sipas parashikimeve të nenit 172 të Kodit Zgjedhor**.

Në këtë pikë theksohet gjithashtu se kjo qasje e Partisë Demokratike është e përsëritur dhe e evidentuar edhe përgjatë Zgjedhjeve Vendore të 14 Majit 2023 (shih më shumë [Denoncimin Nr. 10 “Lidhur me organizimin e koncerteve përgjatë ose në lidhje me tubimet elektorale nga Koalicioni Bashkë Fitojmë dhe Partia Socialiste”](#), datë 11.05.2023).

Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi,

Me konsideratë,

**Për Koalicionin Për Reforma, Integrim
dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)**

**Premto Gogo
Kryetar**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Lidhja Nr. 1: Pasqyrimi me foto dhe link-e i tubimit elektoral të PD-ASHM.

1.1. Faqja Zyrtare në Facebook e [Partia Demokratike e Shqipërisë](#).

#LIVE - Hapja e fushatës elektorale ‘PD-ASHM’



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

1.2. Faqja zyrtare në Facebook e [Kryetarit të Partisë Demokratike Z. Sali Berisha](#).

[#LIVE](#) - Hapja e fushatës elektorale ‘PD-ASHM’




Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania